

**RELACION**  
**PËR PROJEKT-URDHRIN E KRYEMINISTRIT**  
**“PËR NGRITJEN E TASK - FORCËS NDËRINSTITUCIONALE PËR**  
**SEZONIN TURISTIK 2025”**

**I. QËLLIMI I PROJEKT-URDHRIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projekt-urdhri, që vjen si propozim i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, është ngritja e Task - Forcës Ndërinstucionale edhe për sezonin turistik 2025, e cila do të asistojë Komitetin për Menaxhimin e Sezonit Turistik (KMST) dhe është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin në afat të masave përgatitore të përcaktuara në planin e masave, miratimi i planit të masave për sezonin turistik 2025.

Në vijim të problematikave të hasura gjatë sezonit turistik veror 2024, lind e nevojshme që edhe për vitin 2025, të ndiqet e njëjtë procedurë për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik.

Ngritja dhe funksionimi i Task – Forcës Ndërinstucionale do të sigurojë një bashkëpunim institucional koherent me qëllim mbarëvajtjen e sezonit turistik duke menaxhuar fluksin e lartë të turistëve dhe shërbimet në këtë periudhë.

**II. VLERËSIMI I PROJEKT-URDHRIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij projekt-urdhri është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKT-URDHRIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Nëpërmjet ngritjes së Task-forcës synohet:

- Koordinimi në nivel ekspertësh për shkëmbimin e shpejtë të informacionit nëpërmjet institucioneve të përfshira në Task-Force me qëllim mbarëvajtjen dhe menaxhimin e sezonit turistik;
- Rritja e sigurisë së turistëve në vend;
- Sigurimi i pastërtisë në nivele të larta në territor;

- Menaxhimi i zhurmave në zonat turistike;
- Rritja e prezencës së shërbimit shëndetësor ambulator në zonat me fluks të lartë turistësh;
- Menaxhim i mirë i fluksit të turistëve në pikat e kalimit kufitar tokësor, ajror dhe detar;
- Reduktim i informalitetit nëpërmjet kontrolleve nga organet perjegjese; Rritja e cilësisë së shërbimeve turistike të ofruara nga subjektet si struktura akomoduese, stacione plazhi, restorante, transport rrugor, operator të turizmit detar etj;

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projekt-urdhri është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës, të të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar dhe të pikës 1, të nenit 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 649, datë 16.10.2024 ““Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit””.

Gjithashtu, bëjmë me dije se ky projekt-urdhër nuk përfshihet në kategorinë e akteve të ndaluara në kuptim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregulator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 21.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregulator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, sipas të cilit përcaktohet se ndër veprimtaritë e ndaluara janë:

“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerra e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përsitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatëvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive

apo shpérblimeve, përvëç kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkontrolltar apo zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.”

Përsa më sipër, sqarojmë se projekt-urdhri që po paraqesim për shqyrtim dhe miratim nuk parashikon dhënie përfitimi për kategori të caktuara të popullsisë, dhe aq më tepër nuk lidhet me: rritje page, pensionesh, mbështetje ekonomike apo sociale, ulje ose heqje të taksave, falje të kamatëvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënie të pasurive a të shpérblimeve

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE***

Ky projekt-urdhër nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-URDHrit:**

Projekt-urdhri për ngritjen e Task-Forcës ndërinstitucionale të sezonit turistik parashikon si më poshtë:

Ngritja e Task-Forcës ka për synim asistimin që do t'i bëhet Komitetit për Menaxhimin e Sezonit Turistik 2025 (KMST) dhe njëkohësisht do të jetë përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin në afat të masave përgatitore të përcaktuara në planin e masave për sezonin turistik. Task-Forca do të asistohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe në përbërje do të ketë përfaqësues nga institucionet qëndrore si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Prefekturat, agjenci dhe drejtori të përgjithshme në varësi të institucioneve të sipërpërmendura.

Task-Forca për sezonin turistik 2025 do të ketë disa detyra kryesore:

- Të udhëzojë përgatitjen dhe të miratojë tëresinë e veprimtarive që do të kryejë çdo institucion/agjenci zbatuese, në zbatim të planit të masave për sezonin turistik;

- Të bashkërendojë veprimtaritë ndërmjet institucioneve zbatuese. Të analizojë në vijimësi zbatimin e masave për çdo institucion;
- Të propozojë, nëse është e nevojshme, nxjerrjen e akteve nënligjore, që i shërbejnë zbatimit të masave përgatitore, sipas planit të masave;

Të ngarkojë me detyra drejtuesit dhe strukturat zbatuese të drejtpërdrejta, të veprimtarive të planifikuara në planin e masave për sezonin turistik. Në lidhje me organizmin e mbledhjeve, Task-Forca do të mblidhet të paktën, 2 (dy) herë në muaj dhe çdo përfaqësues do të raportojë mbi ecurinë e veprimtarive për institucionin/agjencinë zbatuese që përfaqëson. Ndërsa Ministri i Turizmit dhe Mjedisit do t'i raportojë Kryeministrin për rezultatet e arritura dhe për çështje të rëndësishme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E URDHRIT**

Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Kombëtar i Mbrotjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Mbrotjes Civile, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrotura, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Task-Forca e Transportit Rrugor, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Agjencia Kombëtare e Turizmit, për zbatimin e këtij urdhri.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-URDHRIT**

Për hartimin e këtij projekt-urdhri kanë kontribuar Drejtoria e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Turizmit.

Plani i masave është dërguar për mendim pranë: Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe

Inovacionit, Autoritetit Rrugor Shqiptar, Policisë së Shtetit, Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Taskë-Forcës së Transportit Rrugor, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Task-Forcës së Transportit Rrugor.

Institucionet që kanë dhënë dakordësinë, duke konfirmuar draftin e planit të masave janë:

- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Departamenti për Kufirin dje Migracionin;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

**Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore** ka konfirmuar planin e masave duke propozuar, që masa “*Monitorim i pastrimeve frekuente në zonat turistike, organizim i aksioneve për pastrimin të territoreve të zonave turistike, veçanërisht në kohën e flukseve të larta të vizitorëve*” të ndryshohet si vijon: “*Koordinim ndërinstitucional me Prefekturat, mbi monitorimin e pastrimeve frekuente në zonat turistike, organizimin e aksioneve për pastrim të territoreve në zonave turistike, para dhe gjatë sezonit turistik.*”

*Ky propozim u mor në konsideratë dhe u reflektua në shtojcën e planit të masave.*

**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**, konfirmon planin e masave, duke propozuar si më poshtë:

- Aksioni kundër informalitetit mbi deklarimin e punonjësve dhe pages reale.
- Kontrolli I subjekteve tregtare për zbatimin e procedurës së fiskalizimit.
- Kontrolli I subjekteve tregtare në destinacionet turistike për lëshimin e faturës tatimore dhe me vlerë reale.

- Kontrolli I Subjekteve tregtare në destinacionet turistike për ekspozimin e listës së cmimeve për produkt/shërbimet e ofruara,në vende të dukshme për publikun.
- Verifikimi I subjekteve tregtare që operojnë nëpërmjet booking,Airbnb për shtimin e deklarimeve dhe minimizimin e subjekteve të paregjistruara.
- Kontrolli për dokumentacionin e subjekteve që kanë në përdorim hapësirat publike në plazhe, konratën e përdorimit të stacionit të plazhit nga bashkia përkatëse dhe nëse kanë përmbushur detyrimin ligjor të regjistrimit të tyre në organet tatimore

Këto propozime u morën në konsideratë dhe u shtuan në planin e masave.

**Ministria e Mbrojtjes** ka konfirmuar planin e masave, duke përcjellë sugjerimin e Prefekturës së Qarkut Tiranë, si më poshtë:

- Në kolonën “Institucion”, me numër rendor “10”, ku institucionet përgjegjëse janë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të shtohet dhe institucioni i Prefektit të Qarkut si institucion përgjegjës.

Ky sugjerim u mor parasysh dhe u reflektua në masën me nr. rendor 10, duke shtuar si institucion përgjegjës edhe Prefekturën e Qarkut Tiranë.

**Agjencia Kombëtare e Mjedisit**, lidhur me inspektimet dhe kontrollet propozon heqjen e masave, si më poshtë:

- Ngritja e grupeve të punës për monitorimin, verifikimin dhe evidentimin ne nivel qendror, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në nivel rajonal, në Agjencitë Rajonale të Mjedisit, për zbatimin e kërkesave ligjore e nënligjore, mbi parandalimin e shkarkimeve të ujërave të patrajuara në mjedisin ujor, detar, liqenor; veprimitari të ndaluara në brigje e plazhe dhe shfrytëzimi i inerteve lumore me leje të përdorimit ujor;
- Evidencimi i të gjithë subjekteve që gjenerojnë ujëra të ndotura në vijën bregdetare e liqenore dhe inspektimin e tyre, lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore e nënligjore, për trajtimin e ujrate të ndotura në impiantet përkatëse, largimin e tyre në kolektorët e Ujësjellës Kanalizimeve apo me subjekte të licensuara dhe kontraktuara nga ana e tyre, sipas legjislacionit në fuqi;

Ky propozim u mor parasysh duke hequr nga plani i masave aktivitetet e mësipërme.

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** ka konfirmuar planin e masave duke propozuar, që masa “Të kryhen analizat e ujërave të detit dhe të rritet numri i stacioneve të monitorimit. Identifikimi i burimeve direkte dhe indirekte të ndotjes së plazheve. Të publikohen rezultatet.” të ndryshohet me masën: “Të bëhet Vlerësimi Mikrobiologjik I Ujërave Bregdetare të Larjes dhe të rritet numri I stacioneve të monitorimit. Identifikimi I burimeve direkte dhe indirekte të ndotjes së plazheve. Të publikohen rezultatet.”.

Ky propozim u reflekrua duke ndryshuar masën përkatëse.

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** ka konfirmuar planin e masave duke propozuar shtimin e masave, si më poshtë vijon:

- Rritja e sigurisë për turistë në zonat e mbrojtura;
- Marrje masash për të bërë të mundur grumbullimin dhe largimin e mbetjeve nga zonat e mbrojtura.

Sugjerimi i mor parasysh duke shtuar masat e propozuara në planin e masave.

**Agjencia Kombëtare e Bregdetit** konfirmon planin e masave, duke propozuar si më poshtë:

- Ushtimi i kontrollit dhe inspektimit në të gjitha stacionet e plazhit në vijën bregdetare, për përbushjen e kritereve dhe standardeve në bazë të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 “”Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, inspektimi i operatorëve të turizmit detar, sipas ligjit nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar”, si dhe inspektimi i të gjitha veprimtarive turistike në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit Nr. 93/2015 “Për Turizmin”, të ndryshuar, si dhe ligjet nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ndjekja e procesit të pastrimit të zonës bregdetare nga operatori ekonomik i kontraktuar për realizimin e këtij shërbimi, për përiudhën 15 Qershor - 15 Shtator 2025, për Bashkitë Durrës, Kavajë, Himarë, Sarandë, Rrogozhinë, Vlorë, Lezhë dhe Shkodër, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 06.12.2023, “*Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 17.07.2019, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”*”, i ndryshuar.
- Ndjekja e procesit të aplikimeve për stacione sezonale ankorimi/bregëzimi, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 29.4.2022 “Për kriteret e vendosjes dhe të

funkcionimit të stacioneve sezionale të ankorimit/bregëzimit”, sipas Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 280, datë 19.09.2022, nr. 6073/4 prot., “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të kërkesave për zhvillimin e veprimtarisë së stacioneve sezionale të ankorimit/bregëzimit”.

- Ndjekja e procesit të pastrimit të zonës bregdetare nga operatori ekonomik i kontraktuar për realizimin e këtij shërbimi, për përiudhën 15 Qershori -15 Shtator 2025, për Bashkitë Shkodër, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë.
- Takime me njësitë vendore, prefekturat dhe institucionet kompetente për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, si dhe diskutimin e planit të masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2025.
- Monitorimi i zhvillimeve dhe ndërhyrjeve në zonën bregdetare, si dhe bashkëpunimi me institucionet kompetente që operojnë në zonën bregdetare dhe në zonat ku ushtrohen veprimtari turistike.
- Të kontribuojë në monitorimin e zonave që kanë prezencë të mbetjeve urbane të ngurta dhe mbetje të tjera me impakt negativ në mjedis, përgjatë akseve kombëtare dhe atyre që të çojnë në destinacionet turistike dhe raportimin pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Autoritetit Rrugor Shqiptar, Njësive Vendore dhe Prefekturës përkatëse, si dhe monitorimi i mbetjeve në zonat turistike bregujore.
- Raportime pranë institucioneve kompetente për të gjitha shkeljet që do të evidentohen në terren, përgjatë monitorimeve të përditshme, me qëllim marrjen e masave për parandalimin e tyre;
- Monitorimi i parcelave të përcaktuara si plazhe publike, kritereve dhe standarteve në këto plazhe, sipas përcaktimeve të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.
- Realizimi i detyrate funksionale në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, të ndryshuar.

Propozimet e AKB u morën parasysh duke u shtuar në planin e masave.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUHETORE**

Zbatimi i projekt-urdhrit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

**MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

